




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040 për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr.110 – 391, të dt. 25.02.2010, të nenit 7 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 01-020/01-194101/18, të dt. 08.08.2018, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë:

V E N D I M

- I. MIRATOHET Vendimi për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për subvencione, nga fusha e kulturës për kategoritë: Festivale, Mbështetje të aktiviteteve vjetore të organizatave dhe operatorëve kulturorë, Muzikë, Shoqëri kulturo- Artistike, Trashëgimi kulturore dhe Turizëm- Faza e parë.
 - II. Anëtarë të cekur në pikën I të këtij vendimi janë:
 1. Lindita Cervadiku - Dibra, Drejtorja e Kulturës;
 2. Rreze Kryeziu – Breznica, anëtare e jashtme;
 3. Valdet Rama, Drejtorja e Kulturës;
 4. Fjollë Caka, anëtare e jashtme;
 5. Albana Zhushi, Drejtorja e Financave;
 6. Arjona Caraku (anëtare rezervë), Drejtorja e Kulturës.
 - III. Detyrat e komisionit të cekur në pikën II të këtij vendimi janë të përshkruara në nenin 8 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës 01-020/01-194101/18 dt. 08.08.2018 dhe Rregulloren MF-NR- 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
 - IV. Për kryerjen e detyrave si në pikën III të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Komunës.
 - V. Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.
- I DORËZOHET:
- Anëtarëve të komisionit;
 - Qendrës për shërbim me qytetar;
 - Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS
Përparim Rama

